

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTERIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION

Njësia Org. _____
 Org. Jedinica _____
 Org. Unit _____
 Nr. i Prot. _____
 Broj Prot. _____
 Prot. No. _____
 Data: _____
 Datum: _____
 Date: _____

Nr. i Prot. _____
 Broj Prot. _____
 Prot. No. _____
 Data: _____
 Datum: _____
 Date: _____

Nr. i Prot. _____
 Broj Prot. _____
 Prot. No. _____
 Data: _____
 Datum: _____
 Date: _____

Nr. i Prot. _____
 Broj Prot. _____
 Prot. No. _____
 Data: _____
 Datum: _____
 Date: _____

PRISHTINË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTERIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Njësia Org. _____
 Broj Prot. _____
 Prot. No. _____
 Data: _____
 Datum: _____
 Date: _____

KM-MIT
 2+8t
 Nr. i Prot. 482/19
 Broj Prot. 482/19
 Prot. No. 482/19
 Data: 11-07-19
 Datum: 11-07-19
 Date: 11-07-19

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 Ministria Infrastrukturës dhe Transportit
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
 Ministry of Infrastructure and Transportation

Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, në mbështetje të nenit 145 (paragrafit 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe neni 38 (paragrafi 3) të rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave (22.03.2011), Rregulloren nr. 26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2011 Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave, nenit 84 dhe 131 të Ligjit nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr. 20/21 Qershor 2016), nenit 5 dhe 21 Ligjit nr. 04/L - 179 për Transportin Rrugor, Udhëzimin Administrativ 06/2016 për plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendit të Udhëtimit të Transportit Ndërrurban të Udhëtarëve me Autobus, dhe rekomandimit të komisionit të caktuar me vendimin nr. 5517 të dt. 23.05.2019, nxjerr këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa pranueshme ankesa nr. prot. 4621 të dt. 03.05.2019 e parashtruar nga operatorët transportues N.T.T. "NIKU TOURS", N.T.P. "BALA", N.T.T. "KUKLECI" dhe N.T.T. "FLORIANI" që të gjithë nga Istogu, kundër vendimit për shpalljen e nisjes në relacionin Istog-Klinë - Prishtinë me nisje në ora 09:00 dhe kthim në ora 11:00.

Arsyetim

Komisionit i emëruar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, me vendimin nr. prot. 5517 të datës 23.05.2019, pas shqyrtimit të ankesës nr. prot. 4621 të dt. 03.05.2019 e parashtruar nga operatorët transportues N.T.T. "NIKU TOURS", N.T.P. "BALA", N.T.T. "KUKLECI" dhe N.T.T. "FLORIANI" që të gjithë nga Istogu, kundër vendimit për shpalljen e nisjes në relacionin Istog-Klinë-Prishtinë me nisje në ora 09:00 dhe kthim në ora 11:00, ka konstatuar se çështja në fjalë është trajtuar edhe me ankesën nr. 2156 të dt.04.03.2019 e parashtruar nga po të njëjtit operatorë, e cila ankesë është trajtuar duke marrë përgjigje me vendimin e nxjerrë nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit dt. 13.05.2019 me nr. prot. 4972, përmes të cilës ankesa është refuzuar sipas arsyesimit të vendimit në fjalë. Andaj bazuar në vendimin me nr. prot. 4972 të dt. 13.05.2019 gjegjësisht këshillën juridike dhënë në vendim, pala e pa kënaqur mund të parashtroi padi në Gjykatën Kompetente.

Bazuar në atë që u cekë më lartë, këshillës juridike dhënë në vendimin Ministrit Infrastrukturës dhe Transportit nr.prot. 4972 të dt. 13.05.2019, konsiderohet se ankesa në fjalë trajton çështjen e njëjtë dhe për këtë ka marrë përgjigje në vendimin nr.prot. 4972 të dt. 13.05.2019, kështu që mbështetur në këtë dhe nenin 132 par.2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ nuk është shqyrtuar pasi që ankesa nuk është e pranueshme.

Prandaj, në mbështetje të nenit 132 par.2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ministri Infrastrukturës Transportit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi dhe vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Zyrës së Arkivit të MI -së.

